

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.02.2025*

24.02.2025
Ora 14:11

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e disa kërkesave për regjistrim si subjekt zgjedhor nga disa parti politike, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu.

Parti Politike: PS (znj. E. Xhina), PD (z. F. Nuri),
Lëvizja Bashkë (znj.V. Çipi).

Të tjerë: **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme publike kemi shqyrtimin e disa kërkesave për regjistrim si subjekt zgjedhor, nga disa parti politike. Po Licela! Relatimin bëje për të gjitha.

Znj. L. Veliu: Në kuadër të procesit të regjistrimit si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025, kanë depozituar para KQZ-së kërkesat e tyre partitë politike si vijon:

Partia Nisma Thurje, me kryetar Endrit Shabanin.

Partia Lëvizja Bashkë, me kryetar Arlind Qorrin.

Partia Shqipëria Bëhet, me kryetar Artiatik Lapaj.

Partia Mundësia, me kryetar Agron Shehaj.

Partia Demokristiane e Shqipërisë, me kryetar Nard Ndoka.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.02.2025*

Partia Lëvizja e Legalitetit, me kryetar Shpëtim Axhami.

Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë, me kryetar Dhimitër Muslia.

Partia Kombëtare Konservatore Albania, me kryetar Kujtim Gjuzi.

Partia Demokratike, me kryetar Sali Berisha.

Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, me kryetar Zef Bushati.

Partia Balli Kombëtar Demokrat, me kryetar Artur Roshi.

Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, me kryetar Ylber Valteri.

Partia Balli Kombëtar, me kryetar Adriatik Alimadhi.

Partia Lirisë, me kryetar Ilir Metaj.

Partia Socialiste e Shqipërisë, me kryetar Edi Rama.

Bashkëlidhur kërkesës nga secila parti politike është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në referim të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimit nr. 2 i datës 22 janar 2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë së datës 11 Maj 2025”. Bazuar në shqyrtimin dhe verifikimin e kryer dokumentacioni shoqërues i paraqitur nga partitë politike është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar. Bashkëlidhur gjeni projektvendimet përkatëse për miratim.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues të partive politike, kemi? Po!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Faleminderit zoti Celibashi: Jemi këtu për të paraqitur edhe një herë kërkesën tonë për regjistrimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë me kryetar Sali Berisha. Gjykojmë se kërkesa është e plotë nga ana formale dhe ana subsancionale dhe kërkojmë pranimin e saj. Gjithashtu përfitoj nga

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.02.2025*

rasti meqë mora fjalën edhe për diçka, jashtë rendit të ditës, nëse më lejohet. Një shqetësim në lidhje me procesin e regjistrimit të diasporës. Kërkoj nga ana juaj si Komisioner një sqarim se çfarë do të bëjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në lidhje me mundësinë që në platformën PER të regjistrohen edhe ata qytetarë shqiptar që kanë patjetër nënshtetësinë tonë shqiptare dhe që patjetër figurojnë në listat e zgjedhësve. Çfarë masash do të marrë, apo ka ndërmend të marrë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mënyrë që edhe ata shtetas, që nuk e kanë një mjet identifikimi, letërnjoftim biometrik, apo pasaportë të mund të regjistrohen. Pra, konkretisht a do të lejohet, apo jo votimi i atyre qytetarëve që janë të pajisur me pasaportë, apo me letërnjoftimi të vendeve të Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Australisë, Kanadasë, Britanisë së Madhe e me rradhë? Ky është edhe shqetësimi i parë. Gjithashtu kemi edhe një shqetësim tjetër që na ka ardhur rishtazi. Na është bërë me dije, i nderuar zoti Komisioner që ka shtetas të regjistruar në platformën PER, kanë deklaruar një adresë e cila është pranuar, mirëpo për një arsye apo tjetrën adresa e tyre mund të ketë ndryshuar, adresa fizike në diasporë mund të ketë ndryshuar apo mund të ndryshojë gjatë kësaj periudhe. Si e ka parashikuar KQZ-ja adresimin e kësaj situate? Na është raportuar për disa raste në Greqi në lidhje me tërmetet e caktuara etj., etj., ku ka pasur zhvendosje popullsie. Mund të ketë edhe në vende të tjera raste nga më të ndryshmet. Por, flasim përtej rasteve konkrete. Në përgjithësi si do ta adresojë KQZ këtë dinamikë. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Diskutime të tjera, përfaqësuesit e tjerë të partive politike. Nuk ka? Mirë, faleminderit! Atëherë, lidhur me çështjen e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesa për regjistrim të disa partive politike si subjekt zgjedhor, në vlerësim edhe të çfarë u relatua nga stafi i KQZ-së, vendosim regjistrimin si subjekt zgjedhor të:

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.02.2025*

- Partia Shqipëria Bëhet, me kryetar zotin Adriatik Lapaj.
- Partia Nisma Thurje, me kryetar zotin Endrit Shabanin.
- Partia Lëvizja Bashkë, me kryetar zotin Arlind Qorrin.
- Partia Shqipëria Bëhet, me kryetar zotin Artiatik Lapaj.
- Partia Mundësia, me kryetar zotin Agron Shehaj.
- Partia Demokristiane e Shqipërisë, me kryetar zotin Nard Ndoka.
- Partia Lëvizja e Legalitetit, me kryetar zotin Shpëtim Axhami.
- Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë, me kryetar zotin Dhimitër Muslia.
- Partia Kombëtare Konservatore Albania, me kryetar zotin Kujtim Gjuzi.
- Partia Demokratike e Shqipërisë, me kryetar zotin Sali Berisha.
- Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, me kryetar zotin Zef Bushati.
- Partia Balli Kombëtar Demokrat, me kryetar zotin Artur Roshi.
- Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, me kryetar zotin Ylber Valteri.
- Partia Balli Kombëtar, me kryetar zotin Adriatik Alimadhi.
- Partia Lirisë, me kryetar zotin Ilir Metaj.
- Partia Socialiste e Shqipërisë, me kryetar zotin Edi Rama.

Mirë me këtë pikë të rendit të ditës përfunduar.

Në përgjigje të çfarë përfaqësuesi i Partisë Demokratike prezantoi, do të dua të sqaroj sa vijon:

Përsa i përket regjistrimit të dokumentit të identifikimit të atyre votuesve nga jashtë që regjistrohen nëpërmjet platformës PER, mendoj që kjo çështje është e qartë pasi Kodi Zgjedhor e ka përcaktuar që do të duhesh të kesh një dokument identifikimi biometrik të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, për t'u regjistruar në platformën PER pavarësisht faktit nëse ky dokument është i vlefshëm apo jo. Pasi me ndryshimet që ju bënë ligjit për lëshimin e dokumentave të identifikimit me aktin normativ, tashmë çdo votues nga jashtë, i cili edhe pse nuk ka një dokument

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.02.2025*

identifikimi biometrik të vlefshëm ai mund të regjistrohet dhe mund të votojë. Nëse nuk zotëron një dokument identifikimi biometrik, qoftë të vlefshëm, apo jo, nuk mund të regjistrohesh në platformën PER dhe rrjedhimisht nuk mund të votosh. Kjo është një çështje e ligjit, e zgjidhur kështu nga ligji. Gjithsecili prej nesh mund të ketë diskutime dhe pikëpamje në lidhje me këtë zgjidhje ligjore, por kjo është situata. Në cilësinë e Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, rikonfirmoj dhe një herë që mungon një obligim, për pozicionin tim si Komisioner, nga Kodi Zgjedhor për të ndërmarr qoftë si propozues, apo edhe si miratues akte të tjera shtesë përta i përket procesit të regjistrimit. Do të ishte e udhës që Kuvendi i Shqipërisë, partitë politike ta kishin adresuar këtë çështje. Nuk e adresuan, të paktën flas për Komisionerin Shtetëror, pastaj për dy organet e tjera drejtuese ato flasin vet. Por, për Komisionerin Shtetëror nuk ka asnjë detyrim tjetër të buruar nga Kodi Zgjedhor për t'u përfshirë në këtë proces. Përta i përket rastit të nevojës së disa votuesve nga jashtë, të cilët tashmë janë regjistruar në platformë për të ndryshuar adresën, ka një mënyrë që ne e kuptojmë të gjithë, por nuk është shumë e përshtatshme nga pikëpamja praktike për votuesin nga jashtë. Ne e kemi marrë vendimin, e kemi regjistruar. Do të thotë për ligjin ai është regjistruar. Do të duhet që pasi të dalë lista paraprake të bëjë kërkesën për ndryshimin e adresës. Si moment ligjor ky është i vetmi moment. Ne po shohim si do ta adresojmë këtë kërkesë nga pikëpamja teknike dhe do të gjejmë një zgjidhje për raste të tilla që të mos i fusim në një proces të rënduar të shqyrtimit administrativ të këtyre kërkesave. Po këto kërkesa ata t'i paraqesin përsëri nëpërmjet PER-it dhe po nëpërmjet PER-it ta marrin këtë miratim, nëse do të jetë rasti për ndryshim. Për ndryshe do të duhet që të bëjnë një kërkesë. Do të ketë një shqyrtim administrativ, por e dimë shumë mirë që kjo është gati si të mos ja krijosh këtë mundësi këtyre votuesve. Pra, do të duhet të presim datën 4 mars, për ta bërë këtë ndryshim dhe besoj që do ta adresojmë edhe nga pikëpamja teknike ashtu si do të

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.02.2025*

duhet që të jetë me dobi dhe efikasitet për të gjitha palët. Faleminderit! Ditë të mbarë!
Çështje të tjera nuk kemi? Mirë, seanca mbyllet.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*

